



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.03/617 ;

Data: 15.10.2024.

Bazuar në nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 17, 16 Shtator 2011), nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/l-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/l-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e vijuesve të rritur në arsimin e mesëm të lartë të arsimit profesional klasa e dhjetë (X-të)

Nr.	Shkolla	Nr.i paraleleve	Nr. i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	SHML "28 Nëntori"	1	20	Ndërtimtari-Ndërtimtari	20
		1	20	Ndërtimtari -Arkitekturë	20
		1	20	Ndërtimtari -Gjeodezi	20
		1	20	TIK-PTT	20
		1	20	Grafikë	20
	Gjithsej	5	20		100
2	SHML "Hoxhë Kadri Prishtina"	1	26	Ekonomi-Konatbiletet dhe tatime	26
		1	26	Ekonomi-Shpedicon dhe logjistikë	26
		1	26	Ekonomi-Marketing dhe shitje	26
		1	26	Juridik,administrat dhe sherbime të zyres	26
	Gjithsej	4	26		104
3	SHML "7 Shtatori"	1	24	Ekonomi-Tregëti me pakicë dhe shumicë	24

		1+1	24+24	Hoteleri- Gjellëberës dhe Pastiçeri	48
		1	24	Hoteleri-Asisten I mikëpritjes hoteliere	24
		1	24	Turizëm-Asistent I mikëpritjes hoteliere	24
	Gjithsej	5	24		120
4	SHML "Abdyl Frashëri"	1	15	Bujqësi: Agrobiznes	15
		1	15	Bujqësi: Hortikulturë	15
		1	15	Bujqësi: Mbrojtje e bimëve	15
		1	15	Teknologji ushqimore: Përpunues i ushqimit dhe profesionet e ngjashme	15
		1	15	Teknologji ushqimore: Furrtari	15
		1	15	Veterinë: Veterinari	15
	Gjithsej	6	15		90
5	SHML "Gjin Gazulli"	2	24+24	Informatikë	48
		1	24	Telekomunikacion	24
		1	24	Energjetikë	24
	Gjithsej	4	24		96
Total					510

I. Dokumentet për regjistrim

- Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt;
- Dëftesa e klasave të kryera paraprake;
- Certifikata e lindjes;
- Pagesa (referohu në pikën e III-të të këtij konkursi).

II. Kushtet dhe kriteret ligjore për regjistrim në programin "Arsimi për të rritur"

- Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt;
- Regjistrimi i vijuesve në programin "Arsimi për të rritur", bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në



III. Pagesa në arsimin e mesëm të lartë

- Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë për të gjithë të regjistruarit është me pagesë;
- Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur është, si vijon:
 - a) për regjistrim të vitit (për një klasë 100 €)100 €;
 - b) për praktikë profesionale50 €;
 - c) provim diferenciale..... 10 €;
 - d) provimi përfundimtar, certifikatën-diploma 50 €;
- Pagesat bëhen në institucionet përkatëse edukativo-arsimore sipas kodeve të shkollave.
- Participimi bëhet në bazë të Rregullores nr. 01/2017, dt. 02.02.2017 për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur dhe Rregullores për të hyra vetanake të institucioneve arsimore të Komunës së Prishtinës: 01. nr. 110 - 157460, dt. 01.07.2014.

IV. Provimet diferenciale

- Kandidatët, të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht t'u nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale, bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 16/2011, për kalimin e nxënësit të shkollës së mesme të lartë prej një profili arsimor në tjetrin ose prej një shkolle në shkollën tjetër;
- Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës, për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 15.10.2024 deri më datën 30.10.2024;
- Formulari i aplikimit merret në shkollën përkatëse që aplikoni;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në shkollën përkatëse që aplikoni;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

